



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr. 2176, datë 29.10.2012**

**Për**

**“Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Albanian Mobile Communications sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

*Miratimi i Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Albanian Mobile Communications sh.a. (AMC)*

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 8 dhe pikat 3 dhe 5 të nenit 52 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.
3. Rregullorja Nr.19 datë 14.06.2010 per “ Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1300, datë 14.06.2010, i ndryshuar (*Rregullorja e Akses/Interkoneksionit*).
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2119, datë 04.07.2012.

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e AMC me Nr.prot.1943 datë 08.10.2012, nëpërmjet së cilës AMC ka depozituar në AKEP Ofertën Referencë të Akses/Interkoneksionit dhe Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit.
2. Projektvendim i KD të AKEP “Për Miratimi i Ofertës Referencë të Interkoneksionit të AMC sh.a”.
3. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*), si dhe,
4. Nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

## V Ë R E N:

1. Bazuar në VKD nr. 2119, datë 04.07.2012, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, ka depozituar në AKEP Ofertën Referencë të Akses/Interkoneksionit dhe Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit.
2. Gjatë procesit të kontrollit të ofertës referencë të interkoneksionit të AMC, sipas pikës 3 të nenit 52 të ligjit nr. 9918, AKEP ka vënë re se oferta referencë i plotëson kryesisht të gjitha kërkesat që lidhen me kushtet e veçanta, për ndershmërinë, transparencën, mosdiskriminimin, arsyeshmërinë dhe grafikun kohor të ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit sipas detyrimeve të ligjit 9918, rregullores së akses/interkoneksionit, Vendimit nr. 2119, datë 04.07.2012, si dhe kushteve të tregut, midis të tjerave në elementë të tillë si:
  - a. Arsyeshmërinë për afatin kohor të vlefshmërisë së marrëveshjeve të interkoneksionit dhe procedurave për rinovimin e tyre;
  - b. Vendosjen e cmimeve të shërbimeve të përfshira në ofertën referencë;
  - c. Afatet kohore për ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit dhe masa apo penalitetet për mos-realizimin e tyre etj;
  - d. Heqjen e statusit me FNT për origjinimin<sup>1</sup> dhe terminimin e thirrjeve hyrese ndërkombëtare;
3. Megjithatë nga shqyrtimi është vënë re se në seksionin 2.4 të Aneks II, janë përfshirë tarifat e shërbimeve të qarkut E1, kur interkoneksioni i realizuar është i ndërmjetëm ose në anën e operatorit përfitues (shërbimet 107 dhe 108), por me përshkrim jo të saktë. AKEP ka bërë disa saktësime në përshkrimin e shërbimeve 107 dhe 108 të RIO. Keto tarifa megjithëse nuk janë nën-rregullim janë të detyrueshme për t’u përfshirë në RIO: kërkesë e rregullores së akses/interkoneksionit (neni 11, germa ‘o’). Tarifat për keto shërbime janë vendosur sipas propozimit të AMC por duke saktësuar përshkrimin e

---

<sup>1</sup> Per origjinimin e thirrjeve AMC ka detyrim të zbatohet të njejtat terma dhe kushte, përfshirë tarifat, deri me 31.12.2012, sipas përcaktimeve të VKD nr. 2119, datë 04.07.2012

shërbimit. AMC të drejtë ndryshimin e këtyre tarifave sipas përcaktimeve të pikës 7.2 të RIO (Pjesa Kryesore).

4. Ne RIO të propozuar nga AMC sh.a janë bërë disa ndryshime për t'a unifikuar me atë të operatorëve të tjere celulare, me qëllim lehtësimin e marrëdhënieve të operatorëve përfitues për interkonektim me operatorët celularë me FNT.
5. AKEP, bazuar në pikën 3 të nenit 52, ka të drejtë të imponojë ndryshime në ofertën referencë në rast se ajo nuk plotëson kriteret e referuara në këtë nen të ligjit.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Albanian Mobile Communications sh.a., së bashku me Marrëveshjen për Nivelin e Shërbimit si pjesë e saj, sipas dokumentit bashkëngjitur këtij vendimi në Aneks nr.1.
2. Albanian Mobile Communications sh.a. të publikojë në faqen e tij të Internetit ofertën referencë të interkoneksionit të miratuar me këtë vendim, brenda një jave nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)
4. Albanian Mobile Communications sh.a dhe palët e interesuara kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ, për këtë vendim dhe ofertën referencë të interkoneksionit, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. Alban **KARAPICI**
2. Alketa **MUKAVELATI**
3. Benon **PALOKA**
4. Zamira **NURCE**

**ANEKS 1:**

**OFERTA REFERENCË E INTERKONEKSIONIT E ALBANIAN MOBILE  
COMMUNICATIONS SH.A.**

Miratuar me VKD Nr. 2176, datë 29.10.2012